



**Strategjia e Kontrollit  
të Lartë të Shtetit**

**2023 - 2027**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT  
KRYETARI**

Nr. 146/6 Prot.

Tiranë, më 29.12.2022

**VENDIM**

**Nr.247, Datë 29/12/2022**

**PËR**

**MIRATIMIN E STRATEGJISË SË ZHVILLIMIT TË KLSH, 2023 - 2027**

Bazuar në Ligjin nr.154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, Metodologjinë e Hartimit të Planit Strategjik dhe Vjetor të Auditimit, miratuar me Vendimin nr. 79, datë 30.06.2018 të Kryetarit të KLSH-së, Urdhrin nr. 15, datë 01.02.2022 “Për ngritjen e grupit të punës, i cili me mbështetjen e ekspertëve të IDI do të hartojë Strategjinë e Zhvillimit të KLSH-së për 2023-2027”, i ndryshuar me Urdhrin nr. 84, datë 12.10.2022, Strategjinë e Zhvillimit 2018-2022, si dhe në zbatim të rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë dhe Raportit të Vetëvlerësimit të KLSH-së, sipas dokumentit të INTOSAI-t “Korniza e Matjes së Performancës së SAI-eve” miratuar me Vendimin nr. 225, datë 02.12.2022, të Kryetarit të KLSH-së,

**VENDOSA:**

1. Miratimin e Strategjisë së Zhvillimit 2023-2027.
2. Ngarkohet Drejtoria e Metodologjisë, Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit për koordinimin e punës për hartimin e planit të veprimit për implementimin e Strategjisë 2023-2027.
3. Ngarkohen, për implementimin e Strategjisë, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtori i Përgjithshëm, Drejtorët e Departamenteve/Drejtorive si dhe të gjithë punonjësit e KLSH-së.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**

**Arben SHEHU**



## Përmbajtja

Hyrje.....	5
1. Metodologjia.....	6
2. Rezultatet e Strategjisë 2018-2022 .....	8
3. Rezultatet nga vetëvlerësimi i performancës (PMF) .....	10
4. Analiza SWOT.....	12
5. Qëllimi ynë .....	14
VIZIONI .....	14
MISIONI.....	14
VLERAT DHE PARIMET .....	14
6. Qëllimet Strategjike .....	17
8. Si do të arrihen qëllimet .....	20
9. Mjetet që do të përdorim .....	22
10. Partnerët strategjikë .....	25
11. Si do ta masim performancën tonë.....	26
12. Rolet dhe Përgjegjësitë .....	29

## **FALENDERIME**

Ky dokument u hartua me mbështetjen e Iniciativës për Zhvillim të INTOSAI (IDI) dhe ekspertëve të SAI-t të Norvegjisë, me të cilin u nënshkrua marrëveshja e bashkëpunimit në maj 2022, duke dhënë kontribut të vyer në rritjen e kapaciteteve institucionale dhe profesionale të stafit të Kontrollit të Lartë të Shtetit nëpërmjet konsulencës dhe praktikave më të mira.

## Hyrje



Vitet e fundit, qytetarët, institucionet dhe vetë qeveria janë përballur me një sërë sfidash. Ngjarjet si, tërmeti i nëntorit të vitit 2019 e më pas pandemia COVID-19, kërkuan ndërhyrjen e menjëhershme të qeverisë, ku përgjigjia ndaj tyre solli dhe vijon të sjellë edhe për disa vite, implikime në shpenzimet publike dhe ofrimin e shërbimeve publike.

Krahas sa më sipër, Shqipëria vijon të jetë përballë sfidës për integrimin në Bashkimin Evropian dhe përmbushjes së planeve ambicioze të Axhendës 2030 për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm.

Korrupsioni gjithashtu mbetet ende një fushë shqetësuese serioze. Për të përmirësuar përgjegjshmërinë publike, transparencën dhe llogaridhënien e qeverisë, KLSH do të vijojë të mbështesë institucionet publike, duke identifikuar mangësitë, shpërdorimet dhe shkeljet në përmbushjen e rregullt të detyrës nga ana e zyrtarëve publikë, dhe duke i shoqëruar ato me rekomandimet përkatëse, pasi në këtë mënyrë i shërbehet mbi të gjitha parandalimit të fenomeneve abuzive, kontribut i cili kushton shumë më pak, se sa pasojat e keq menaxhimit dhe të abuzimeve financiare.

Ndërkohë, zhvillimet teknologjike pritet të ndikojnë edhe në mënyrën dhe cilësinë e ofrimit të shërbimeve publike, të shoqëruara edhe me situata të reja emergjente si, sulmet kibernetike, kriza energjetike, etj, të cilat diktojnë gjithashtu nevojën për përgatitjen e planeve fleksibël të veprimit.

*“Duke identifikuar mësimet e nxjerra nga eksperiencia të mëparshme, duke zbatuar praktikatat më të mira si edhe duke u angazhuar me INTOSAI-n dhe partnerët e jashtëm, SAI-et mund të përmirësojnë reagimin e tyre ndaj dinamikave të mjedisit”.*

Deklarata e Rios - INCOSAI XXIV

Në të njëjtën linjë dhe me çështjet e diskutuara në Kongresin INCOSAI XXIV, të zhvilluar në nëntor 2022 në Rio de Janeiro, KLSH do të vijojë të orientohet drejt përgjigjes efektive ndaj sfidave dhe kërkesave të kohës, duke rritur edhe më tej aftësinë për t’iu përshtatur në kohë ndryshimeve në mjedisin rrethues, nëpërmjet investimit në ekspertizën e nevojshme dhe të domosdoshme edhe në fusha të tilla si zhvillimet dixhitale, qëndrueshmëria e financave

publike, efektiviteti dhe eficientia e menaxhimit të programeve qeveritare, kryesisht në ato të partneritetit publik-privat, e të tjera fusha me ndikim në financat publike.

Gjithë sa më sipër, e vendos KLSH-në përpara nevojës për një shqyrtim edhe më të kujdesshëm, të performancës së qeverisë dhe institucioneve publike, mbi mënyrën se si menaxhohen situatat dhe paraja publike, duke ofruar nga njëra anë, mbështetje efektive për Kuvendin për shqyrtim të thelluar të çështjeve të menaxhimit të financave publike, dhe nga ana tjetër, duke ofruar siguri dhe transparencë për qytetarin, për nivelin e përgjegjshmërisë me të cilin qeveria po menaxhon paratë dhe pasurinë publike.

**Suksesi i strategjisë, do të qëndrojë në masën, në të cilën KLSH do të mund të influencojë në sistemin e përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies, në ndihmë të forcimit të institucioneve të qëndrueshme.**

Për të arritur këtë qëllim, kjo Strategji, do të orientohet gjithashtu drejt rritjes më tej të cilësisë së auditimeve, duke iu përgjigjur në mënyrë të vazhdueshme zhvillimeve të standardeve dhe rregulloreve të auditimit sipas ISSAI-ve, duke përditësuar metodologjitë, si dhe duke rritur përdorimin e vizualizimeve për të përmirësuar efikasitetin e përcjelljes së punës audituese.

Kjo nënkupton optimizimin e aftësive profesionale dhe njohurive inovative mbi standardet ndërkombëtare të fushës, për të gjithë trupën audituese dhe personelin mbështetës nëpërmjet trajnimeve dhe punës së përbashkët, me qëllimin për të zhvilluar më tej kuptueshmërinë e njohurive audituese, që nxisin veprim dhe prodhojnë rezultat.

Suksesi në këtë drejtim nuk qëndron vetëm në aftësinë e KLSH-së për të përmbushur mandatin ligjor, por edhe në masën në të cilën KLSH do të jetë në gjendje të mobilizohet dhe influencojë ekosistemin e përgjegjshmërisë<sup>1</sup> / llogaridhënies, referuar këtu të gjithë rrjetit të grupeve të interesit, përgjegjës për llogaridhënien e sektorit publik, si dhe përgjegjshmërisë rreth marrëdhënieve qytetar-qeveri, për të nxitur ndryshime pozitive.

Në Deklaratën e Rios, komuniteti INTOSAI ndër të tjera theksoi rëndësinë e parimeve dhe standardeve të auditimit, të cilat udhëzojnë se si SAI-t, të pozicionohen ndaj ekosistemit të llogaridhënies së tyre, për të shtuar vlerë dhe rritur cilësinë e punës së tyre.

## 1. Metodologjia

Për hartimin e strategjisë institucionale 2023-2027, Kontrolli i Lartë i Shtetit është mbështetur në Iniciativën e Strategjisë, Matjes së Performancës dhe Raportimit, të hartuar nga Iniciativa për Zhvillim e INTOSAI-t (IDI), pjesë e të cilës kanë qenë edhe shumë institucione të tjera

<sup>1</sup>. Ekosistemi i përgjegjshmërisë përbëhet nga aktorët, proceset dhe faktorë të tjerë të lidhur, si dhe marrëdhëniet ndërmjet këtyre elementeve, të cilat përbëjnë dhe ndikojnë në reagimin dhe llogaridhënien e qeverisë, si pozitivisht ashtu edhe negativisht.

homologe të auditimit publik. Qëllimi i kësaj iniciative ka qenë mbështetja nga pikëpamja metodologjike e procesit, duke ndjekur një qasje “hap pas hapi” për planifikimin strategjik, e përshtatur me nevojat dhe kontekstin e secilit vend. Kjo qasje vendosi në qendër të vëmendjes, performancën e SAI-ve, të mbështetur mbi një vlerësim holistik dhe të pavarur, siç edhe përcaktohet në Kornizën e Menaxhimit Strategjik të SAI-t.

Me qëllim realizimin me sukses të qasjes së parashikuar, KLSH gjatë procesit të hartimit të planit strategjik, aplikoi një sërë mjetesh vlerësimi si:

- ✓ Ngritja e grupit të punës, me përfaqësues të nivelit të lartë të KLSH-së, të dedikuar për të formuluar çështjet strategjike, apo identifikimin e indikatorëve të performancës në funksion të zhvillimit të një kuadri pune për planin strategjik, të prioritarizuar, të kuptueshëm dhe gjithëpërfshirës.
- ✓ Procesi i vetëvlerësimit të performancës për çdo dimension.
- ✓ Rekomandimet e Kuvendit miratuar në rezolutën përkatëse.
- ✓ Vlerësimet dhe rekomandimet e misioneve të BE-së në kuadër të zbatimit të Reformës në Menaxhimin e Financave Publike, apo të procesit të integritetit si pjesë e Kapitullit 32 për nënkomponentin, “Auditimi i jashtëm”.


Sa më sipër, u materializua fillimisht në 14 trajnime dhe workshop-e, të organizuara në 3 module, udhëhequr nga IDI, në bashkëpunim edhe me SAI-n e Norvegjisë, i cili mbështeti procesin me ekspertizën e nevojshme në këtë fushë. Në përfundim të këtyre trajnimeve, u zhvilluan 4 produktet kryesore që janë:

- ✓ Projekt plani i detajuar për hartimin e Strategjisë së KLSH-së, ku u identifikuan hapat përgjatë procesit si dhe afatet dhe përgjegjësitë e ekipeve të përcaktuara për realizimin e tyre; si dhe
- ✓ Raporti i Vetëvlerësimit të Performancës së KLSH, si hapi i parë dhe më i rëndësishëm për hartimin e planit strategjik,
- ✓ Analiza SWOT, ku bazuar edhe në rezultatet e Raportit të Vetëvlerësimit të Performancës, u identifikuan çështjet strategjike të organizuara sipas 4 komponentëve: fuqitë, mundësitë si dhe dobësitë dhe kërcënimet të cilat mund të shtojnë rrezikun për ndikim në cilësinë e punës audituese apo mbulimit me auditim, për shkak të ndryshimit të rrethanave dhe zhvillimeve institucionale,
- ✓ Plotësimi i Pyetësorit Gjjinor.

Pas hartimit të dokumenteve të mësipërme, grupi i punës për hartimin e planit strategjik, mbështetur nga sekretariati, si dhe në konsultim të vazhdueshëm me ekspertët e IDI, ka vijuar me shtjellimin dhe saktësimin e qëllimeve strategjike, objektiveve, aktiviteteve dhe treguesve për kryerjen e monitorimit në vijim të këtij plani. Në përfundim të hartimit dhe miratimit të Planit Strategjik, hartohet edhe plani operacional i cili do të konkretizojë veprimtaritë që do të zhvillohen çdo vit për zbatimin e planit strategjik.

## 2. Rezultatet e Strategjisë 2018-2022

Strategjia e Zhvillimit të KLSH 2018-2022 përcaktoi 3 qëllime strategjike dhe 21 objektiva të cilat mbuluan dimensionet më të rëndësishme të zhvillimit të institucionit.



KLSH fokusoi përpjekjet për zhvillim institucional duke vendosur si **qëllim të parë strategjik rritjen e impaktit të punës audituese me fokus 6-E**. Për përmbushjen e këtij qëllimi, KLSH ka punuar në forcimin e pavarësisë dhe mandatit kushtetues, në rritjen e cilësisë së auditimeve, në forcimin e ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve dhe në kontributin në luftën kundër korrupsionit.

Në funksion të forcimit të pavarësisë dhe mandatit kushtetues, KLSH ka paraqitur disa propozime për ndryshime ligjore Kuvendit të Shqipërisë, në përputhje kjo edhe me sa rekomanduar në progres raportin e BE-së,

rekomandim, i cili do të vijojë të jetë pjesë e Strategjisë së Zhvillimit 2023-2027, për një vlerësim më të plotë dhe koherent të nevojës për ndryshime.

Me qëllim rritjen e cilësisë së punës audituese në të gjitha llojet e auditimit, është hartuar Manuali Aktiv i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit dhe janë përditësuar: manuali i Auditimit të Performancës, Manuali i Auditimit Financiar dhe Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare.

Gjithashtu është përmirësuar formati i Raporteve të Auditimit, reflektuar dhe në përmirësimin e Rregullores së Procedurave të Auditimit të KLSH. Për të gjitha këto ndryshime, janë kryer një sërë trajnimesh me stafin auditues. Puna në drejtim të rritjes së nivelit të zbatimit të rekomandimeve është konkretizuar në hartimin e Manualit të Ndjekjes së Zbatimit të Rekomandimeve dhe në plotësimin periodik të regjistrit elektronik të zbatimit të rekomandimeve të Kuvendit. Kështu, për periudhën 2018-2022 janë dhënë në total 13,746 rekomandime, konkretisht në vitin 2018 janë dhënë 4,232 rekomandime; në vitin 2019 janë dhënë 3,441 rekomandime; në vitin 2020 janë dhënë 1,430 rekomandime; në vitin 2021 janë dhënë 4,251 rekomandime dhe deri në shtator të vitit 2022 janë dhënë 3,833 rekomandime.

Vetëm për vitin 2021, pavarësisht shkallës së lartë të pranimit të rekomandimeve, me më shumë se 90%, shkalla e zbatimit të tyre ishte 55%, tregues i cili duhet të përmirësohet më tej. KLSH duke e konsideruar thelbësor zbatimin e rekomandimeve, si dhe referuar edhe rekomandimeve të BE-së në Progres Raportin 2022, e ka mbartur këtë objektivi, si një ndër 3 qëllimet strategjike për 5 vjeçarin e ardhshëm.

Gjithashtu është intensifikuar marrëdhënia me Kuvendin për të nxitur institucionet e audituara që të zbatojnë rekomandimet e KLSH-së. Për periudhën 2018-2022 janë dërguar në Kuvend në total 583 raporte auditimi, nga të cilat, vetëm për vitin 2022, janë dërguar 137 raporte.

Sa më sipër, edhe në linjë me rekomandimet e BE-së<sup>2</sup> mbi rritjen e mbikëqyrjes parlamentare në subjektet e audituara, rritja e zbatimit të rekomandimeve të KLSH përmes dëgjesave më të shpeshta parlamentare dhe krijimit të një kuadri monitorimi të rregullt të veprimeve të qeverisjes, do të vijojë edhe në Strategjinë e Zhvillimit 2023-2027.

Sa i përket kontributit në luftën kundër korrupsionit, KLSH ka pasur një rol të vazhdueshëm proaktiv dhe produktiv nëpërmjet auditimeve, denoncimit të rasteve korruptive dhe shkëmbimit të informacionit në kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimit me Strukturën e Posaçme Anti Korrupsion (SPAK), Prokurorinë e Përgjithshme, Inspektoriatin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit (ILDKPKI), etj. Bashkëpunimi i KLSH-së në luftën kundër korrupsionit ndjek një filozofi gjithëpërfshirëse, duke përkrahur, mbështetur dhe u angazhuar në çdo iniciativë ndër institucionale, brenda dhe jashtë vendit, për hartimin e dokumentave strategjikë përkatës.

Sipas sondazhit të opinionit publik “Besimi në Qeverisje 2021”, kryer nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM), i cili shqyrton perceptimin publik dhe qëndrimet e qytetarëve në çështje, si: besimi në institucionet publike, transparencja dhe llogaridhënia institucionale, korrupsioni, niveli i përfshirjes qytetare në politikëbërje dhe vendimmarrje, kënaqshmëria me ofrimin e shërbimeve publike, menaxhimi i fatkeqësive natyrore dhe zbatimin e ligjeve dhe politikave për mbrojtjen nga diskriminimi, KLSH perceptohet si mekanizmi më efikas për llogaridhënie në vend (71.1%).

**Qëllimi i dytë Strategjik, lidhej me "Optimizimin e kapaciteteve profesionale, aftësive audituese, procedurave të punës, logjistikës dhe funksioneve të tjera mbështetëse".**

Nën këtë objektiv, KLSH i ka kushtuar një vëmendje të veçantë zhvillimit të vazhdueshëm profesional të stafit të KLSH-së, si një prej prioriteteve kryesore në ngritjen dhe forcimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore, në bashkëpunim kjo me partnerë të brendshëm dhe të jashtëm si: ASPA, OSBE/ANAC, SECO, SIGMA si dhe me INTOSAI-n, EUROSIAI-n dhe SAI-t homologe. Procesi i trajnimit të vazhdueshëm funksionon në mënyrë efektive, duke u përmirësuar në vijimësi, në formë dhe përmbajtje dhe duke u konsoliduar, në frymën e Kongresit të XXII të INTOSAI-t, ku 192 SAI-t anëtare ranë dakord se: “... për të përcaktuar profesionalizimin si një proces të vazhdueshëm, me të cilin audituesit dhe organizatat e tyre, SAI-t sigurojnë nivele të larta të ekspertizës, kompetencës, sjelljes etike dhe të cilësisë, mbështetur në standardet profesionale (ISSAI)”. Gjatë periudhës 2018-2022, çdo auditues ka zhvilluar mesatarisht 26 ditë trajnimit në vit. Temat e trajtuara në trajnime variojnë nga

<sup>2</sup> BE\_Progres Raport SWD (2022) 332, datë 12.10.2022

manualet dhe standardet e auditimit, te procedurat e prokurimeve, PPP-të, infrastruktura dixhitale, etj.

Gjatë periudhës 2018-2022 audituesit kanë marrë pjesë në aktivitete të ndryshme në kuadër të bashkëpunimit me institucione ndërkombëtare për forcimin e kapaciteteve audituese. 22 auditues kanë përfunduar me sukses programet e internship-t në Gjykatën Evropiane të Llogarive (ECA) dhe 6 auditues kanë ndjekur programet e fellowship-it pranë Zyrës së Auditimit të Qeverisë së SHBA (GAO), si dhe të tjerë tashmë, zotërojnë certifikata ndërkombëtare profesionale.

Nëpërmjet programit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional, KLSH ka bërë të mundur rritjen e njohurive dhe aftësive që ju nevojiten audituesve në realizimin e objektivave, mundësisë individuale për t'u rritur në karrierë, për rrjedhojë përmirësimin ndjeshëm të cilësisë së punës audituese, duke ndikuar në rritjen e transparencës, mirëqeverisjes dhe përdorimin e parasë publike, si dhe në rritjen e besimit tek profesionistët, për rrjedhojë edhe të publikut tek KLSH.

**Në përmbushje të qëllimit të tretë strategjik, i cili konsistoi në forcimin e komunikimit dhe bashkëpunimit me Kuvendin dhe palët e interesit,** KLSH hartoi Strategjinë e Komunikimit 2017-2019, e pasuar kjo nga Strategjia e Komunikimit 2022-2025, si pjesë të domosdoshme për përmbushjen e misionit dhe objektivave strategjike të zhvillimit institucional, bazuar në parimet e gjithëpërfshirjes, transparencës, qartësisë, vërtetësisë, inovacionit, koherencës dhe aksesueshmërisë në informacion.

Gjithashtu, me synimin e institucionalizimit të marrëdhënieve të KLSH-së me Kuvendin e Shqipërisë, në kuadër dhe të rekomandimeve të BE-së, është miratuar Udhëzuesi për institucionalizimin e marrëdhënieve të KLSH-së me Parlamentin, si dhe i është dërguar Kuvendit propozimi për ngritjen e një nën komisioni parlamentar pranë Komisionit për Ekonominë dhe Financat, me qëllim forcimin e mekanizmave të kontrollit parlamentar në funksion të rritjes të zbatimit të rekomandimeve dhe rritjes së llogaridhënies së ekzekutivit. Në funksion të këtij objekti, KLSH ka vijuar të përditësojë me informacion platformën elektronike të Kuvendit të Shqipërisë lidhur me rekomandimet e dhëna për institucionet qendrore dhe atyre të varësisë dhe statusin e zbatimit të tyre. Gjithashtu, Kuvendi është informuar periodikisht për rezultatet e punës audituese edhe nëpërmjet përcjelljes së buletineve statistikore periodike.

Objekti i tretë strategjik, u orientua dhe u mbështet në frymën e Parimit 8, të Standardit Ndërkombëtar të Auditimit ISSAI P-20, që nxit dhe inkurajon transparencën dhe përgjegjshmërinë, ku nënvizohet se *“SAI-t komunikojnë në kohë dhe gjerësisht mbi aktivitetet e tyre dhe rezultatet e auditimit përmes mediave, faqeve të internetit dhe me mjete të tjera”*.

### **3. Rezultatet nga vetëvlerësimi i performancës (PMF)**

Në parapërgatitje të hartimit të strategjisë së zhvillimit institucional, mbështetur nga IDI dhe nga SAI i Norvegjisë, KLSH ka kryer vetëvlerësimin e performancës institucionale sipas

dokumentit të Kornizës së Matjes së Performancës të Institucioneve Supreme të Auditimit, të INTOSAI-t (SAI PMF Framework).

Në përfundim të një procesi të gjatë vlerësues, puna u konkretizua me Raportin e SAI PMF për KLSH, rezultatet e të cilit janë përdorur në konceptimin dhe hartimin e planit strategjik të institucionit. Përdorimi i vlerësimit të PMF është shumëdimensional, duke mos u kufizuar vetëm në përputhshmërinë dhe plotësimin e kërkesave që burojnë nga standardet ndërkombëtare të auditimit (ISSAI), por duke ofruar një perspektivë më të gjerë në përdorimin e rezultateve të tij. Në vijim të sa më sipër, KLSH i bëri rezultatet e këtij raporti pjesë të kuadrit menaxherial institucional, jo vetëm duke i përfshirë në planin e ri strategjik të zhvillimit të KLSH-së 2023-2027, por edhe duke e kthyer procesin e vetëvlerësimit në një mjet periodik të vlerësimit të punës së KLSH-së, përfshirë kjo edhe si pjesë integrale e Raportit Vjetor të Performancës së KLSH-së.


Në përfundim, nga Raporti i Vetëvlerësimit u evidentuan një sërë çështjesh që kërkojnë vëmendje në periudhën në vijim, që lidhen me nevojën për:

- ✓ forcimin e efektivitetit të punës së kryer nga institucioni nëpërmjet propozimit të ndryshimeve ligjore në mbështetje të mandatit dhe pavarësisë së institucionit;
- ✓ forcimin e kapaciteteve audituese në drejtim të auditimeve të PPP-ve dhe kontratave konçensionare;
- ✓ trajnimin e vazhdueshëm të audituesve mbi qasjet audituese, metodologjitë dhe teknikat audituese për audituesit e rinj dhe ata me më eksperiencë;
- ✓ përmirësimin e dokumentimit të punës audituese në mbështetje të gjetjeve të auditimit, duke pasur parasysh gjithmonë përputhshmërinë e plotë me standardet e duke shmangur mbivendosjen e letrave të punës;
- ✓ përmirësimin e vazhdueshëm të manualeve të auditimit, për të reflektuar ndryshimet e vazhdueshme në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit si dhe duke përfituar nga shkëmbimi i eksperiencave audituese brenda dhe jashtë KLSH-së dhe me partnerët tanë ndërkombëtarë;
- ✓ përmirësimet e nevojshme në procesin e planifikimit strategjik veçanërisht për auditimet e performancës, duke hartuar një dokument mbi fushat me risk, ku duhet të fokusohet puna audituese e institucionit;
- ✓ përmirësimin e shkrimit të raporteve në mënyrë që gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e tyre të jenë të qarta dhe të kuptueshme për përdoruesit e tyre;
- ✓ një praktikë të mirë të vlerësimit të materialitetit për të parashikuar rastet se kur një praktike “follow-up”, kërkon vlerësime/auditime të mëtejshme;
- ✓ forcimin e transparencës nëpërmjet publikimit të vazhdueshëm të rezultateve të punës audituese.

## **4. Analiza SWOT**

Si një mjet për planifikimin strategjik, KLSH ka përdorur analizën SWOT për të identifikuar dhe vlerësuar fuqitë, dobësitë, mundësitë dhe kërcënimet që mund të ndikojnë në veprimtarinë institucionale.

Bazuar në këtë analizë, KLSH ka hartuar qëllimet strategjike të cilat do të arrihen duke u mbështetur në fuqitë dhe duke minimizuar dobësitë, si dhe duke shfrytëzuar shanset dhe shmangur kërcënimet.



## 5. Qëllimi ynë

*“Parimet e vendosura në Deklaratat e njëpasnjëshme dhe dokumentet e tjera kryesore të INCOSAI-t, ofrojnë të gjithë bazën për të mundësuar zhvillimin e INTOSAI-t dhe SAI-ve”. Në veçanti INCOSAI thekson rëndësinë e pavarësisë, transparencës dhe rezultateve profesionale.”*

*Deklarata e Rios- INCOSAI XXIV*

### VIZIONI

KLSH është një institucion model që udhëheq nëpërmjet shembullit, që nxit rritjen e përgjegjshmërisë, transparencës, dhe përmirësimin e shërbimeve publike, nëpërmjet auditimeve cilësore dhe luftës kundër korrupsionit, duke forcuar integritetin dhe besimin e publikut tek institucioni.

### MISIONI

Kontrolli i Lartë i Shtetit është institucion i pavarur, kushtetues, i cili nëpërmjet ekspertizës dhe auditimeve cilësore, mbështet Kuvendin dhe informon publikun dhe palët e interesit në mënyrë të vazhdueshme, të paanshme dhe të plotë mbi përgjegjshmërinë që qeveria dhe entet publike tregojnë në menaxhimin e parasë së taksapaguesve, me qëllim përmirësimin e shërbimeve publike.

### VLERAT DHE PARIMET

Në linjë me INTOSAI P-12 *“Vlerat dhe Përfitimet e Institucioneve Supreme të Auditimit - Një ndryshim në jetën e qytetarëve”*, KLSH ka adoptuar parimet që përcaktojnë mënyrën sesi institucioni duhet të përmbushë mandatin për të forcuar përgjegjshmërinë, transparencën dhe integritetin e qeverisë dhe njësive të sektorit publik, për të demonstruar rëndësinë e vazhdueshme për qytetarët, Parlamentin dhe aktorët e tjerë, si dhe për të qenë një organizatë model që udhëheq nëpërmjet shembullit duke ruajtur vlerat e mëposhtme:

#### **1. Forcimi i llogaridhënies, transparencës dhe integritetit të qeverisë në njësitë e sektorit publik, i cili arrihet nëpërmjet parimeve:**

**Pavarësi:** Pavarësia është thelbësore për çdo auditim dhe jetike për të fituar besimin e publikut dhe të Parlamentit, për t’i ofruar atyre informacione objektive dhe të paanshme. Pavarësia e KLSH-së parakupton që i gjithë procesi i auditimit, që nga planifikimi, realizimi dhe raportimi i nënshtrohet vetëm kërkesave të standardeve profesionale dhe është jashtë çdo lloj ndikimi. KLSH duhet të jetë e pavarur në ngritjen dhe zbatimin e mekanizmave të duhur për ndjekjen dhe monitorimin e rekomandimeve si dhe në raportimin e çështjeve që mund të ndikojnë në aftësinë për të kryer aktivitetet në përputhje me mandatin dhe/ose kuadrin ligjor dhe rregullativ.

**Nxitje e përgjegjshmërisë së institucioneve publike:** KLSH kryen auditime me qëllim garantimin që qeveria dhe entitetet e sektorit publik janë të përgjegjshëm për administrimin dhe përdorimin e burimeve publike. Në veprimtarinë e tyre, audituesit e KLSH-së veprojnë në interes të publikut dhe janë të angazhuar për të mbështetur Kuvendin për të shqyrtuar llogaridhënien e qeverisë.

**Cilësi dhe përmirësim i vazhdueshëm:** KLSH synon që nëpërmjet auditimeve cilësore, t'u mundësojë personave të ngarkuar me qeverisjen e sektorit publik, të përmbushin përgjegjësitë e tyre në përgjigjen ndaj gjetjeve dhe rekomandimeve të auditimit dhe marrjen e veprimeve të duhura korrigjuese. KLSH siguron komunikim të qartë dhe korrekt me subjektet e audituara duke i mbajtur ata vazhdimisht të informuar gjatë procesit të auditimit. Për sa më sipër, nevojitet që KLSH, pa kompromentuar pavarësinë, të ofrojë këshillim mbi mënyrën se si gjetjet e auditimit mund të optimizojnë efektin e tyre në financat publike. KLSH krijon marrëdhënie profesionale me komitetet përkatëse mbikëqyrëse dhe drejtuesit e subjekteve të audituara, për t'i ndihmuar ata që të kuptojnë më mirë raportet e auditimit, konkluzionet dhe të marrin masa për zbatimin e tyre.

**Raportim i rezultateve të auditimit që nxisin llogaridhënien:** KLSH raporton informacion objektiv, në një mënyrë të thjeshtë, të qartë dhe me gjuhë të kuptueshme si dhe publikon raportet e auditimit në mënyrë periodike, duke lehtësuar aksesin në to, nëpërmjet mjeteve të duhura të komunikimit.

## **2. Demonstrimi i rëndësisë dhe konsideratës së duhur ndaj qytetarëve, Parlamentit dhe grupeve të tjera të interesit, i cili arrihet nëpërmjet parimeve si vijon:**

KLSH demonstroi në mënyrë të vazhdueshme, rëndësinë dhe konsideratën, duke iu përgjigjur në kohë problematikave të përcjella nga qytetarët; pritshmërive të palëve të ndryshme të interesit; risqeve dhe dinamikave të mjedisit ku po kryhen auditimet, duke qenë:

**Reagues ndaj ndryshimeve dhe dinamikeve:** KLSH gjatë realizimit të procesit e auditimit vepron vetëm në shërbim të interesit të përgjithshëm publik. Rezultatet e punës audituese nuk ndikohen nga preferencat politike, etnike, fetare apo familjare, të stafit të KLSH-së, por udhëhiqen nga parimi i rritjes së mirëqenies së qytetarit shqiptar, nëpërmjet mirëqeverisjes dhe rritjes së eficiencës, efektivitetit dhe ekonomicitetit të përdorimit të fondeve publike.

**Komunikues me grupet e interesit:** KLSH komunikon në një mënyrë që të rrisë njohuritë dhe kuptueshmërinë e grupeve të interesit mbi rolin dhe përgjegjësitë e KLSH-së, si institucioni më i lartë, i pavarur, i kontrollit financiar të sektorit publik. KLSH komunikon me grupet e interesit për të siguruar kuptueshmërinë e punës audituese dhe rezultateve të saj. Gjithashtu, KLSH ndërvepron me median për të lehtësuar komunikimin me qytetarët si dhe angazhohet me grupet e interesit, duke njohur rolet e tyre përkatëse dhe marrë në konsideratë pikëpamjet e tyre, pa kompromentuar pavarësinë institucionale. Për të rritur efektivitetin e komunikimit me grupet e interesit, KLSH kryen monitorim dhe vlerësim të vazhdueshëm mbi besueshmërinë e tyre ndaj KLSH-së.

**Burim i besueshëm analizash objektive dhe të pavarura:** Puna audituese e KLSH-së bazohet në gjykimin profesional e të pavarur. KLSH, si një partner aktiv në sektorin publik kombëtar, sa herë kërkohet, përdor njohuritë që zotëron për të mbështetur reformat në sektorin publik, siç janë ato në fushën e menaxhimit të financave publike. Në këtë drejtim, merr rëndësi vlerësimi periodik që KLSH kryen, nëse palët e interesuara besojnë se KLSH është efektive dhe kontribuon në përmirësimin e sektorit publik. Gjithashtu, KLSH bashkëpunon me INTOSAI-n si dhe me organizata të tjera profesionale ndërkombëtare, me qëllim promovimin e rolit të komunitetit të SAI-ve për të adresuar çështje globale që prekin auditimin në sektorin publik, kontabilitet dhe llogaridhënie.

### **3. Shndërrimi në një organizatë model, duke udhëhequr nëpërmjet shembullit, i cili arrihet nëpërmjet parimeve si vijon:**

KLSH duhet të jetë një institucion i besueshëm bazuar në faktin nëse shihet si i pavarur, kompetent dhe përgjegjës për veprimet e veta, duke ofruar:

**Transparencë dhe përgjegjshmëri:** KLSH kryen funksionet institucionale në mënyrë të tillë që siguron llogaridhënie, transparencë dhe mirëqeverisje. Për këtë, KLSH bën publike përgjegjësitë, misionin dhe strategjinë si dhe standardet e auditimit, proceset dhe metodat objektive, që përdor për të përmbushur detyrat e saj. Gjithashtu, KLSH menaxhon me efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet aktivitetet në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe raporton mbi çështjet e caktuara, duke i bërë gjithashtu publike.

**Përputhshmëri me parimet e mirëqeverisjes:** Aktiviteti i KLSH vazhdimisht ka qenë dhe do të vijojë të jetë subjekt i vlerësimit të jashtëm, të pavarur si psh “peer-review”. KLSH rishikon dhe përshtat kur nevojitet, strukturën e brendshme në funksion të organizimit menaxherial, me qëllim impaktin pozitiv ndaj proceseve të mirëqeverisjes dhe në mbështetje të efektivitetit të kontrollit të brendshëm.

**Integritet:** KLSH angazhohet për kultivimin e vlerave më të mira etike-profesionale dhe morale për të luajtur rol kyç në luftën kundër korrupsionit. Veprimtaria e auditimit kryhet jashtë çdo konflikti interesi, dhe objektiviteti, integriteti dhe kompetenca profesionale janë ndër parimet kyçe të veprimtarisë së KLSH-së në përditshmërinë e saj.

**Cilësi:** KLSH harton dhe zbaton politika dhe procedura që promovojnë një kulturë të brendshme që vlerëson dhe siguron cilësinë përgjatë kryerjes së punës audituese e që kërkojnë zbatim nga të gjitha hallkat e institucionit, brenda fushës së kompetencës respektive. Në përmbushje të këtij parimi, KLSH duhet të ketë burimet e duhura dhe të mjaftueshme për të kryer detyrat me sukses. Këto politika dhe procedura promovojnë vijimësi në kontrollin e cilësisë së punës audituese duke identifikuar përgjegjësitë për mbikëqyrje dhe rishikim, elementë këta të nevojshëm për krijimin e një procesi monitorues relevant, i duhur dhe që operon me efektivitet.

**Zhvillim profesional të kapaciteteve audituese:** KLSH vijon të promovojë zhvillimin profesional të stafit auditues, që kontribuon në përsosmërinë e individit dhe të organizatës në tërësi, nëpërmjet zhvillimit të trajnimeve dhe nxitjes së kualifikimeve të fushës. KLSH inkurajon ndarjen e njohurive dhe mbështetjen në praktikën e mira me INTOSAI-n, SAI-it homologe dhe grupe të tjera rajonale për të qenë në koherencë me ngjarje dhe/ose çështje të reja nëpërmjet shkëmbimit të eksperiencave.

## 6. Qëllimet Strategjike

Tre qëllimet strategjike që do të udhëheqin punën e KLSH-së në pesë vitet e ardhshme janë:

- 1. Rritja dhe përmirësimi i rolit të KLSH si mbështetës i Kuvendit për llogaridhënie efektive dhe shqyrtim të kujdesshëm e të thelluar të enteve përdoruese të fondeve publike.**
- 2. Rritja e impaktit të punës audituese në qeverisjen e mirë, nëpërmjet përmirësimit të nivelit të zbatimit të rekomandimeve.**
- 3. Optimizimi i kapaciteteve profesionale me qëllim zotërimin e njohurive inovative në punën audituese.**

### **1. Rritja dhe përmirësimi i rolit të KLSH si mbështetës i Kuvendit për llogaridhënie efektive dhe shqyrtim të kujdesshëm e të thelluar të fondeve publike.**

KLSH dhe Kuvendi si pjesë e trekëndëshit të llogaridhënies, kanë role reciprokisht mbështetëse për të siguruar një qeverisje efektive dhe janë partnerë kryesor në promovimin e qeverisjes së mirë. Kuvendi mund të kryejë funksionet e tij vitale të mbikëqyrjes së aktivitetit qeveritar në mënyrë efeciente dhe efektive, kur ai përdor dhe mbështetet mbi punën audituese të KLSH-së. KLSH mund të jetë shumë më efektiv, nëse Kuvendi dhe komisionet e tij, sigurojnë forume për paraqitjen dhe diskutimin e rezultateve të rëndësishme të auditimeve, duke përbërë aleatin kyç në nxitjen e Ekzekutivit dhe në inkurajimin e institucioneve të tjera të pavarura, për të ndërmarrë veprimet e duhura korrigjuese të propozuara nga KLSH.

KLSH, nëpërmjet punës audituese synon të sigurojë një rritje të rolit të tij si institucion suprem auditimi në mbrojtje të financave publike në vendin tonë, duke përmirësuar performancën e vet institucionale audituese në përfitim të taksapaguesve dhe në mbështetje të Kuvendit për një shqyrtim të thelluar të punës së ekzekutivit.

Në sajë të kryerjes së auditimeve cilësore dhe të thelluara, KLSH do të nxisë përgjegjshmërinë e institucioneve të audituara duke kontribuar kështu, në forcimin e kulturës së llogaridhënies të këtyre institucioneve.

Eksperiencia jonë si institucion i pavarur në shërbim të qytetarëve dhe Kuvendit, ka treguar rëndësinë e auditimeve për palët e interesit dhe përdoruesit e punës audituese, e reflektuar kjo

edhe me një pasqyrim të shtuar në media, si dhe në vlerësime pozitive nga partnerët tanë strategjikë.

Me qëllim sigurimin e një vazhdimësie të qëndrueshme dhe të suksesshme në këtë drejtim, KLSH do të angazhohet drejt një konsolidimi të imazhit të vet institucional, si institucioni suprem i auditimit në Shqipëri, në mbrojtje të financave publike. Situatat emergjente gjithashtu, mund të diktojnë nevojën e adaptimit të planeve të auditimit për t'ju përshtatur ndryshimeve. Në këto kushte, identifikimi i mësimave nga eksperiencat e mëparshme, implementimi i praktikave të mira si dhe angazhimi i KLSH-së me INTOSAI-n dhe partnerët e jashtëm, vlerësohet si një faktor për përmirësimin e përgjigjes në kohë ndaj ndryshimeve, në përputhje kjo edhe me Deklaratën e Rios 2022. KLSH do të konkretizojë këtë qëllim strategjik duke:

- ✓ konsoliduar edhe më tej praktikave të planifikimit strategjik të auditimeve bazuar në analizë të përditësuar rrisht të bazuara në metodologji bashkëkohore, si pjesë e pandashme e planifikimit strategjik të auditimeve për të siguruar një mbulim më efektiv dhe cilësor me auditim.
- ✓ u angazhuar maksimalisht në implementimin e plotë të Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit dhe praktikave të mira gjatë gjithë fazave të auditimit, në përfitim të rritjes së profesionalizmit dhe objektivitetit.
- ✓ thelluar bashkëpunimin me Kuvendin, institucionet e tjera ligjzbatuese dhe palët e interesit, me qëllim parandalimin e rasteve abuzive, si kontribut në luftën kundër korrupsionit dhe në të njëjtën kohë, promovimin e punës audituese si gardian i fondeve publike.

## **2. Rritja e impaktit të punës audituese në qeverisjen e mirë, nëpërmjet përmirësimit të nivelit të zbatimit të rekomandimeve.**

KLSH, synon të rrisë impaktin e punës audituese dhe të kontribuojë në qeverisjen e mirë, nxitjen e përgjegjshmërisë, llogaridhënies dhe transparencës së përdorimit të fondeve publike, nëpërmjet dhënies së rekomandimeve praktike, të qarta dhe të orientuara drejt veprimeve konkrete, për përmirësimin e situatës së konstatuar dhe forcimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Monitorimi i nivelit të zbatimit të rekomandimeve nga entet publike të audituara, në bashkëpunim edhe me Kuvendin, me qëllim nxitjen e institucioneve publike për zbatimin e tyre, do të jetë treguesi kryesor për matjen e impaktit të punës audituese.

Duke raportuar gjetjet dhe, dhënë **rekomandime praktike**, KLSH vendos një bazë të shëndoshë për ndërmarrjen e veprimeve korrektuese dhe parandaluese për të përmirësuar qeverisjen dhe menaxhimin e njësive publike.

KLSH do të konkretizojë këtë qëllim strategjik duke:

- ✓ hartuar raporte auditimi, të kuptueshme, të qarta dhe relevante për çdo lexues me qëllim rritjen e aksesueshmërisë në punën audituese, rritjen e numrit të përdoruesve të këtyre raporteve dhe rritjen e impaktit të përgjithshëm të gjeneruar nga to.
- ✓ përdorur teknika të të shkruarit profesional i cili përcjell informacionet, gjetjet dhe rekomandimet në mënyrë të qartë, koncize dhe efektive.

KLSH do të përmirësojë mënyrën e komunikimit me palët e interesit, duke pasuruar me informacion faqen zyrtare të web-it si dhe duke krijuar një hapësirë të dedikuar për qytetarët që të shprehin ankesat dhe kërkesat. Gjithashtu, nëpërmjet intensifikimit të bashkëpunimit me median e shkruar dhe atë audio-vizive, do të rrisë prezencën në këto hapësira.

KLSH synon të jetë një burim i vlefshëm informacioni për mënyrën se si përdoren burimet publike dhe se si mund të përmirësohet performanca e shërbimeve publike.

### **3. Optimizimi i kapaciteteve profesionale me qëllim zotërimin e njohurive inovative në punën audituese.**

Në zbatim të kësaj Strategjie, KLSH do të vlerësojë në vazhdimësi efektivitetin dhe përshtatshmërinë e burimeve të nevojshme në raport me detyrimet mandatore dhe aspiratat strategjike, duke i bërë ato pjesë të mendësisë dhe praktikës institucionale. Në këtë linjë, ky qëllim synon që krahas zhvillimit të vazhdueshëm profesional, të mundësojë një mjedis pozitiv dhe shpërblyes pune të qëndrueshëm dhe që stimulon rezultat në sfida inovative.

Gjithashtu, KLSH synon të rrisë më tej aftësitë e audituesve, në përdorimin e teknologjisë dhe analizimit të të dhënave (big data), në mënyrë që të kryejnë auditime më të thelluara me bazë sistemi, të komunikojnë rezultatet në forma më të kuptueshme dhe inovative, si dhe të rrisin aftësitë reaguese në mënyrë efektive ndaj rrethanave që mund të krijohen si pasojë e situatave emergjente, si ato me të cilat u përballëm në dy vitet e fundit.

*“Një SAI tenton të ruajë ekselencën profesionale të tij, përmes një qasjeje strategjike ndaj kompetencës së audituesit, bazuar në procesin e të mësuarit të vazhdueshëm dhe shkëmbimin e njohurive”.*

Deklarata e Rios- INCOSAI XXIV

## 8. Si do të arrihen qëllimet



**Për qëllimin e parë strategjik “Rritja dhe përmirësimi i rolit të KLSH si mbështetës i Kuvendit për llogaridhënie efektive dhe shqyrtim të kujdesshëm e të thelluar të punës së ekzekutivit”, ne do të fokusohemi te:**

- ✓ **Kryerja e planifikimit strategjik bazuar në analizë të përditësuar risku me qëllim mbulimin efektiv me auditim dhe kryerjen e auditimeve cilësore.**

Planifikimi strategjik, bazuar në analizë risku të përditësuar sipas një intervali kohor të përcaktuar, pa dyshim siguron një menaxhim më efektiv të burimeve në dispozicion të auditimit i cili arrihet duke filluar me përzgjedhje racionale të fushave dhe subjekteve që do të auditohen në përfundim të analizës së riskut, ku veçanërisht është në konsideratë buxheti i akorduar këtyre subjekteve. Përzgjedhja e angazhimeve audituese sipas kësaj metodologjie është hapi i parë i procesit auditues i cili orientohet më tepër drejt garantimit të cilësisë së produktit se sa drejt numrit të subjekteve të audituara.

Për këtë arsye, KLSH do të angazhohet në rrënjosjen e konceptit teorik dhe praktik të riskut si mjet i domosdoshëm në mbështetje të planifikimit strategjik të institucionit.

- ✓ **Implementimi i plotë i Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit dhe praktikave të mira gjatë të gjitha fazave të auditimit**

Implementimi i plotë i Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit dhe praktikave të mira gjatë të gjitha fazave të auditimit është për KLSH objektivi i përhershëm si një nga “imperativët profesionalë” të auditimit dhe audituesve. Zbatimi i vazhdueshëm i këtyre standardeve kërkon një angazhim institucional të gjithanshëm, për t’i përshtatur ato me kontekstin institucional në të cilin KLSH vepron. Ato janë busulla që orienton punën e auditimit dhe siguron orientimet e duhura metodologjike për çdo situatë, rrethanë apo mjedis të ri auditimi.

- ✓ **Komunikimi dhe bashkëpunimi i vazhdueshëm i KLSH-së me Kuvendin**

KLSH do të vazhdojë të intensifikojë komunikimin dhe bashkëpunimin me Kuvendin, duke përcjellë për shqyrtim të gjitha raportet e auditimit, duke organizuar në bashkëpunim dhe me iniciativën e Komisionit për Ekonominë dhe Financave, dëgjesa për çështje me interes të trajtuara në auditime, si dhe duke bashkëpunuar për ngritjen e një nën-komisioni parlamentar për krijimin e një kuadri monitorues për veprimet e qeverisë në zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së.

**Për qëllimin e dytë strategjik “Rritja e impaktit të punës audituese në qeverisjen e mirë nëpërmjet përmirësimit të nivelit të rekomandimeve” ne do të fokusohemi te:**

- ✓ **Promovimi i vazhdueshëm i rolit të KLSH-së dhe punës audituese, si mbrojtës i fondeve publike, nëpërmjet përdorimit të mjeteve të komunikimit.**

KLSH do ta paraqesë dhe komunikojë punën audituese duke përdorur kanalet më efektive të komunikimit për të mbërritur deri tek përdoruesi më i fundit, qytetari. Në funksion të misionit që ka, KLSH synon t’u shërbejë qytetarëve dhe taksapaguesve, duke u ofruar mundësinë dhe aksesin e plotë në informacion për të kontribuar në realizimin e qëllimit të përbashkët, që është mirëqeverisja.

- ✓ **Thellimi dhe shtrirja e bashkëpunimit me institucionet ligjzbatuese**

Bashkëpunimi me institucionet ligjzbatuese do t’i shtojë vlerë punës audituese, duke raportuar rastet korruptive të konstatuara nga KLSH. Për këtë qëllim, KLSH do të rrisë bashkëpunimin për shkëmbimin e informacionit dhe organizimin e aktiviteteve të përbashkëta, me organet e linjës së parë në luftën kundër korrupsionit.

- ✓ **Forcimi i pavarësisë dhe mandatit të KLSH-së**

Pavarësia dhe mandati i KLSH-së janë sanksionuar në Kushtetutë dhe në Ligjin Organik, duke u konsideruar si kusht i domosdoshëm për përmbushjen e misionit dhe arritjen e qëllimeve strategjike. Për të forcuar pavarësinë dhe mandatin kushtetues, KLSH parashikon të përfundojë rishikimin e ligjit organik, me qëllim reflektimin e ndryshimeve më të fundit të rrethanave dhe mjedisit që ka impakt në punën audituese, në përputhje kjo edhe me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit.

- ✓ **Hartimi i raporteve të auditimit, të kuptueshme, të qarta dhe relevante për lexuesin**

Me qëllim që raportet e auditimit të gjenerojnë impaktin e duhur dhe të përcjellin në mënyrë të qartë rezultatet e auditimeve të kryera, gjuha e përdorur në to duhet të reflektojë në shkallën maksimale profesionalizmin e institucionit të kombinuar me qartësinë gjuhësore. Duke qenë se raportet e auditimit të KLSH kanë përdorues të shumtë të cilët jo domosdoshmërisht kanë njohuritë e duhura për të përthithur dhe vënë në përdorim gjetjet dhe konkluzionet e shprehura në këto raporte, lind nevoja që në to audituesi të shprehet mbi gjetjet e auditimit në një mënyrë të qartë, bazuar në fakte të aksesueshme dhe të kuptueshme për këdo që dëshiron të informohet me punën e ekzekutivit, destinacionin dhe eficiencën në përdorimin e fondeve publike në përfitim të qytetarëve taksapagues.

- ✓ **Përdorimi i teknikave të të shkruarit profesional që përcjell informacion, gjetje dhe rekomandime në mënyrë të qartë, koncize dhe efektive**

Një rekomandim i fortë e me impakt pozitiv për subjektin është një rekomandim që adreson shkakun e jo pasojën, është i qartë për subjektin dhe progresi në realizimin e tij është i matshëm për KLSH-në brenda një afati kohor të përshtatshëm.

**Për qëllimin e tretë strategjik “Optimizimi i kapaciteteve profesionale me qëllim zotërimin e njohurive inovative në punën audituese” ne do të fokusohemi te:**

- ✓ **Zhvillimi dhe ruajtja e ekspertizës në fusha/çështje specifike të auditimit në sektorin publik, me fokus në rritje drejt qasjes dixhitale dhe menaxhimit të të dhënave.**

KLSH do të vazhdojë bashkëpunimin me institucionet homologe me qëllim shkëmbimin e njohurive, pasi “*eksperienca e përbashkët na shërben të gjithëve*”. Referuar Deklaratës së Rios 2022, nxitja e një zëri global më efektiv dhe reagimi ndaj ndryshimit të mjedisit dhe risqeve, kërkon që SAI-t të përmirësojnë mënyrën se si punojnë së bashku dhe të angazhohen me palët e interesuara. Nën këtë frymë, angazhimi i KLSH në drejtim të zbatimit të standardeve në komunitetin e INTOSAI – it, krijon mundësinë e shkëmbimit të praktikave më të mira në fushën e auditimit nëpërmjet auditimeve pilot, paralele dhe atyre ndërkombëtare, angazhime këto të ndërmarra tashmë në marrëveshjet e bashkëpunimit bilateral, të finalizuara gjatë vitit 2022.

Ndërkohë, krijimi i një sistemi të strukturuar të zhvillimit profesional do të vijojë të bazohet në bashkëpunimin me organizma profesionale dhe akademike.

- ✓ **Krijimi i një ambienti stimulues, sfidues dhe shpërblyes për stafin auditues, për të krijuar një kulturë pozitive të punuari.**

KLSH do të vazhdojë të krijojë një mjedis pune divers dhe dinamik, duke punësuar njerëz me formime profesionale të ndryshme dhe duke pranuar mendimin ndryshe. KLSH do të vazhdojë të punësojë auditues të rinj dhe profesionistë të talentuar dhe t’i mbështesë për të zhvilluar më tej aftësitë e tyre në fusha specifike të auditimit si dhe rritjen e tyre në karrierë.

- ✓ **Maksimizimi i vlerës së shtuar të punës së KLSH-së nëpërmjet implementimit të planit strategjik, duke synuar në vazhdimësi të qenit e një organizate model.**

## 9. Mjetet që do të përdorim

**Për të përmbushur qëllimin e parë strategjik** nevojiten një sërë aktivitetesh/mjetesh, e konkretisht, për të realizuar me sukses, **planifikimin strategjik bazuar në analizë të përditësuar risku me qëllim mbulimin efektiv me auditim dhe kryerjen e auditimeve cilësore, nevojitet:**

- Identifikimi i fushave që paraqesin risk në financat publike, në dinamikë me zhvillimet makro-ekonomike që i shoqërojnë ato;
- Rishikimi i vazhdueshëm i “Udhëzuesit për Përcaktimin e Fushave me risk për financat publike” për auditimet e performancës, dhe shndërrimin e tij në pjesë përbërëse të metodologjisë që do të udhëheqë procesin e planifikimit drejt fushave me ndjeshmëri të lartë publike;
- Përmbyllja e qëllimeve të Zhvillimit të Qëndrueshëm sipas Axhendës 2030, në përputhje edhe me prioritetet strategjike të INTOSAI-t për periudhën 2023-2028;
- Mbulimi me auditime performance, në 5 vitet e ardhshme, të shtyllave kryesore të OZHQ-ve (SDG) duke u fokusuar në 2-3 fusha të reja çdo vit respektiv, siç janë: Shëndeti dhe mirëqenia; Cilësia e Arsimit; Barazia gjinore; Cilësia e ujit; Përbalimi dhe cilësia e Energjisë; Rritja ekonomike; Konsumi dhe Prodhimi i Përgjegjshëm; Veprimet në lidhje me ndryshimet klimaterike; Ndotja e ujrave/deteve, etj.

#### **Për implementimin e plotë të Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit dhe praktikave të mira gjatë të gjitha fazave të auditimit nevojitet:**

- Sigurimi i vazhdimësisë, profesionalizmit, dhe cilësisë së zbatimit të Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit nëpërmjet adoptimit dhe përditësimit të vazhdueshëm të udhëzuesve dhe manualeve, duke iu përgjigjur në kohë ndryshimeve;
- Përgatitja e Udhëzuesit Specifik për Auditimin e Zbatimit të Buxhetit Shtetit;
- Orientimi drejt auditimeve të sistemeve të kontrollit me qëllim parandalimin e fenomeneve që kanë impakt negativ në financat publike;
- Zhvillimi i moduleve TI për përdorimin e teknikave të Auditimit TI-së edhe në auditimet e përputhshmërisë, financiare dhe të performancës;
- Angazhimi drejt modernizimit logjistik në fushën e TI dhe komunikimit;
- Vijimi i bashkëpunimit me SAI-et homologe dhe me INTOSAI-n nëpërmjet kryerjes së projekteve dhe aktiviteteve të përbashkëta.

#### **Për hartimin e raporteve të auditimit, të hartuar sipas teknikave të të shkruarit profesional me gjetje dhe rekomandime të kuptueshme, të qarta dhe relevante për lexuesin, nevojitet:**

- Përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë së të shkruarit, paraqitjes së saktë të raporteve në përputhje me rregulloren e procedurave të auditimit;
- Angazhimi i vazhdueshëm i audituesve në trajnime mbi metodat e shkrimit të raporteve të kuptueshme e që i komunikojnë gjetjet në mënyrë të qartë, të saktë e profesionale tek lexuesi;
- Nxitja e përdorimit të vizualizimit nëpërmjet trajnimeve nga burime të brendshme dhe të jashtme, për të shpjeguar çështje komplekse në mënyrë më të thjeshtë, për palët e interesit;
- Angazhimi sipas rasteve specifike, i ekspertëve të jashtëm, për një argumentim profesional të gjetjeve dhe formulimin e rekomadimeve të duhura;

- Hartimi i rekomandimeve të qarta, të realizueshme dhe të matshme, duke u fokusuar në rekomandime që trajtojnë shkakun dhe jo pasojën.

**Për të përmbushur qëllimin e dytë strategjik** e konkretisht, **promovimin e vazhdueshëm të rolit të KLSH-së dhe punës audituese, si garantues i mirëpërdorimit të fondeve publike, nëpërmjet përdorimit të mjeteve të komunikimit, nevojitet:**

- Publikimi dhe promovimi i raporteve të auditimit nëpërmjet komunikimit të vazhdueshëm me palët e interesit;
- Forcimi i kapaciteteve për bashkëpunimin me median për publikimin dhe promovimin e punës audituese;
- Pasurimi i vazhdueshëm i faqes zyrtare të KLSH-së; edhe në gjuhën angleze; si dhe krijimi i një hapësire të dedikuar në web për ankesat/kërkesat e publikut, me qëllim rritjen e aksesueshmërisë për të gjitha palët e interesit;
- Organizimi periodik i aktiviteteve promovuese të punës së KLSH-së, në zbatim edhe të Strategjisë së Komunikimit të KLSH-së.

**Për të nxitur dhe forcuar komunikimin dhe bashkëpunimin e KLSH-së me Kuvendin, nevojitet:**

- Bashkëpunimi i vazhdueshëm me Komisionin për Ekonominë dhe Financat për organizimin e dëgjësive të propozuara prej tyre, për çështje me interes të veçantë të trajtuara në auditime, për të rritur kontrollin parlamentar drejt institucioneve të audituara.
- Forcimi i bashkëveprimit me Kuvendin, për të rritur shkallën e zbatueshmërisë së rekomandimeve të KLSH-së, nëpërmjet organizimit të aktiviteteve të përbashkëta.
- Vijimi i komunikimit dhe bashkëpunimit me Ministrinë e Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin, për përcjelljen periodike të raporteve të auditimit me qëllim nxitjen e zbatimit të plotë të rekomandimeve të KLSH-së.
- Përditësimi i periodik i Platformës Ndërinstitucionale on-line të Kuvendit të Shqipërisë, si mjet efektive për informimin në kohë mbi zbatueshmërinë e rekomandimeve të KLSH-së.

**Për të përmbushur qëllimin e tretë strategjik**, nevojiten një sërë aktiviteteve/mjetesh, e konkretisht:

**Për të zhvilluar dhe ruajtur ekspertizën në fusha/çështje specifike të auditimit në sektorin publik, me fokus në rritje drejt qasjes dixhitale dhe menaxhimit të të dhënave, nevojitet:** optimizimi i kapaciteteve profesionale me qëllim zotërimin e njohurive inovative në punën audituese, nëpërmjet aktiviteteve për shkëmbim njohurish, siç janë: praktika të mira, auditime paralele, seminare, workshope, internship-e; me organizma si: (i) INTOSAI-n dhe SAI-t homologe; dhe (ii) ekspertë të fushës dhe personalitete në fushën akademike.

**Për të nxitur krijimin e një ambienti stimulues, sfidues dhe shpërblyes për stafin auditues, për të krijuar një kulturë pozitive të punuari, nevojitet** implementimi dhe monitorimi i

vazhdueshëm i dokumentit të politikave për zhvillimin e burimeve njerëzore të KLSH-së, që do t'i sigurojë stafit të ketë një plan zhvillimi personal që mbështet prioritetet strategjike të KLSH-së dhe njëkohësisht ambiciet personale.

## 10. Partnerët strategjikë

Palët e interesit dhe partnerët strategjikë do të jenë ndër faktorët kryesor në përmbushjen me sukses të qëllimeve të kësaj strategjie:

Angazhimi i KLSH-së me partnerët strategjikë, si edhe implementimi i praktikave të mira, përmirëson reagimin në kohë të KLSH-së ndaj dinamikave të mjedisit.

### Kuvendi i Shqipërisë

Parimet Themelore të vendosura në Deklaratën e Limës (ISSAI 1) dhe Deklaratën e Meksikos (ISSAI 10), kërkojnë që institucioni suprem i auditimit duhet të vendosë dhe të mbajë komunikim dhe marrëdhënie efektive me Parlamentin dhe komisionet përkatëse të tij. Në mënyrë të veçantë, ISSAI 20, nënvizon se: *“Institucionet Supreme të Auditimit të mbajnë një marrëdhënie të fortë me komisionet përkatëse parlamentare për t'i ndihmuar ato të kuptojnë më mirë raportet dhe konkluzionet e auditimit dhe të ndërmarrin veprimet e duhura”*.

### Qytetari shqiptar

Në funksion të misionit të tij, KLSH synon t'u shërbejë qytetarëve dhe taksapaguesve në mënyrë të drejtpërdrejtë, por edhe në mënyrë indirekte duke u siguruar mundësinë dhe aksesin e plotë për të kontribuar në realizimin e qëllimit të përbashkët, atë të mirëqeverisjes.

### Qeveria dhe subjektet e audituara

Me synim mirëmenaxhimin e fondeve publike, KLSH bashkëpunon me Ministrin e Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, duke informuar në mënyrë të vazhdueshme qeverinë mbi rekomandimet e KLSH-së për institucionet qendrore dhe atyre të varësisë, me qëllim hartimin nga Këshilli i Ministrave të akteve që nxisin zbatimin e këtyre rekomandimeve.

### Shoqëria civile

Organizatat jofitimprurëse (OJF), përfshirë dhe shoqatat profesionale, janë një partner i vlefshëm për KLSH-në dhe vendosja e urave të komunikimit mbi baza të rregullta e të

vazhdueshme, do të kontribuojë në ndërmarrjen e auditimeve që trajtojnë tematika me karakter social-shoqëror dhe ekonomik.

### Media

Media si një mjet i komunikimit në masë, do të vazhdojë të jetë një partner i rëndësishëm strategjik i institucionit për pasqyrimin në kohë dhe promovimin e aktivitetit auditues të KLSH-së, përfshirë këtu median e shkruar, audio-vizive dhe atë online.


### Bota akademike

KLSH ka institucionalizuar dhe intensifikuar bashkëpunimin me institucionet akademike, veçanërisht me universitetet publike në Shqipëri, me synim promovimin e punës së audituesit të jashtëm publik, rritjen e kapaciteteve audituese dhe tërheqjen e audituesve të rinj.

### INTOSAI, EUROSAI dhe SAI-t homologe

KLSH është anëtar i Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI) që nga viti 1984 dhe gjithashtu, që prej vitit 1993, është anëtar i Organizatës Evropiane të Institucioneve Supreme të Auditimit (EUROSAI). Bashkëpunimi me këto dy organizata, por edhe në nivel bilateral me SAI-t homologe, do të jenë të rëndësishme në realizimin e objektivave dhe misionit të institucionit në tërësi.

## 11. Si do ta masim performancën tonë



**Rritja dhe përmirësimi i rolit të KLSH si mbështetës i Kuvendit për llogaridhënie efektive dhe shqyrtim të kujdesshëm e të thelluar**

- Periodiciteti i rishikimit të Udhëzuesit të Fushave me Risk në auditimet e performancës, dhe shndërrimi i tij në Metodologji në përfundim të periudhës 5 vjeçare,
- Numri i auditimeve që përzgjidhen dhe kryhen bazuar në Udhëzuesin e Riskut,
- Numri i auditimeve që mbulojnë fushat e rekomanduara nga Axhenda për Zhvillim të Qëndrueshëm 2030,
- Numri i auditimeve të performancës që mbulojnë 6 nga 10 fushat e rekomanduara nga SAI PMF,

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Numri i manualeve dhe udhëzuesve të përditësuar në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit,</li> <li>• Zbatimi në auditim i manualeve apo udhëzuesve të përditësuar,</li> <li>• Përgatitja e Udhëzuesit për Auditimin e Zbatimit të Buxhetit,</li> <li>• Përqindja e auditimeve me bazë sistemi ndaj totalit të auditimeve të realizuara,</li> <li>• Rastet e përdorimit të moduleve të TI edhe në auditimet e tjera financiare apo ato të përputhshmërisë,</li> <li>• Nr i aktiviteteve të përbashkëta me SAI-t homologe dhe INTOSAI,</li> <li>• Numri i auditimeve paralele të kryera me SAI-et homologe,</li> <li>• Përdorimi i rezultateve të kontrollit në të ftohtë kryer nga struktura përgjegjëse,</li> <li>• Nr i ekspertëve të jashtëm të angazhuar në auditime për çështje specifike,</li> <li>• Numri i trajnimeve të kryera mbi metodat e shkrimit të raporteve</li> <li>• Përdorimi i vizualizimeve në raportet e auditimit, dhe raportet periodike te institucionit,</li> <li>• Aksesimi i audituesve në programe TI me qëllim përpunimin e të dhënave dhe lehtësimin e punës audituese duke përdorur skema dhe infografikë,</li> <li>• Përqindja e rekomandimeve të pranuar nga subjektet e audituara,</li> <li>• Përqindja e rekomandimeve të zbatuara nga subjektet e audituara.</li> </ul>
--	---

**Qëllimet strategjike**

**Indikatorët e performancës së KLSH-së**

<p><b>Rritja e impaktit të punës audituese në qeverisjen e mirë, nëpërmjet përmirësimit të nivelit të zbatimit të rekomandimeve</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Numri i raporteve të auditimit që i dërgohen palëve të interesit,</li> <li>• Përqindja e raporteve të publikuara në faqen zyrtare web të KLSH,</li> <li>• Numri i artikujve që publikohen në median e shkruar lidhur me çështje të trajtuara në auditime,</li> <li>• Numri i kronikave që jepen në median audio-vizive lidhur me raportet e auditimit,</li> <li>• Numri i ankesave/kërkesave të qytetarëve që merren nëpërmjet faqes zyrtare web,</li> <li>• Numri i ankesave/kërkesave të qytetarëve, që trajtohen në auditime,</li> <li>• Numri i raporteve të auditimit të shkarkuara nga web dhe numri i vizitorëve në web,</li> <li>• Organizimi i aktiviteteve “Java e Hapur”, 100 vjetori i KLSH”, pjesëmarrja në “Panairin e Librit”,</li> </ul>
---	---

- Bashkëpunimi në ngritjen e nën komisionit parlamentar për çështje të auditimit të jashtëm me iniciativën e Komisionit për Ekonominë dhe Financat,
- Numri i dëgjësave të zhvilluara në Kuvend dhe në Komisionin e Ekonomisë për çështjet me interes të veçantë të trajtuara në auditime,
- Numri i raporteve të auditimit të përcjella në Kuvend,
- Numri i aktiviteteve të përbashkëta me Kuvendin, me qëllim rritjen e shkallës së zbatimit të rekomandimeve,
- Numri i raporteve të auditimit të përcjella në Ministrinë Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin,
- Plotësimi dhe përditësimi periodik i Platformës Ndërinstitucionale Online të Kuvendit mbi zbatimin e rekomandimeve nga subjektet e audituara,
- Numri i marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe tryezave të rrumbullakëta me organet e linjës së parë në luftën kundër korrupsionit dhe rezultatet e arritura
- Paraqitja e propozimeve për ndryshime në ligjin për KLSH nr. 154/2014, në funksion të kontributimit në forcimin e mëtejshëm të efektivitetit të KLSH-së

**Qëllimet strategjike**

**Indikatorët e performancës së KLSH-së**

**Optimizimi i kapaciteteve profesionale me qëllim zotërimin e njohurive inovative në punën audituese**

- Numri i ditëve të trajnimit për çdo auditues,
- Numri i audituesve që kryejnë internship në ECA, GAO apo institucione të tjera me SAI-e homologe,
- Përqindja e audituesve të trajnuar jashtë, dhe që trajnojnë kolegët për të ndarë njohuritë e marra,
- Numri i temave të auditimit të propozuara nga audituesit e trajnuar jashtë, të cilët sjellin praktika të mira,
- Dokumenti i politikave të zhvillimit të burimeve njerëzore.

Raporti:

1. Numri i audituesve të rekrutuar sipas fushës kundrejt numrit total të audituesve;
2. Numri i audituesve të ngritur në detyrë;
3. Niveli i qarkullimit brenda institucionit;
4. Numri i audituesve të trajnuar;

5. Numri i ditë trajnimi/auditues në çdo vit;
6. Databazë për vlerësimin e performancës;
7. Databazë me informacione për zhvillimet profesionale dhe akademike të çdo audituesi.
  - Përqindja e punonjësve që kanë plane personale zhvillimi,
  - Numri i marrëveshjeve të bashkëpunimit me organizma që ofrojnë ekspertizë në fusha specifike,
  - Numri i trajnimeve të realizuara nga ekspertë të ndryshëm,

## 12. Rolet dhe Përgjegjësitë

Strategjia e Zhvillimit 2023- 2027 do të udhëheqë Kontrollin e Lartë të Shtetit në aktivitetin e tij institucional duke u përshtatur dhe përgjigjur në kohë dhe me përgjegjshmëri dinamikave dhe zhvillimeve lokale dhe globale të kohës.

Për këtë qëllim, ky dokument do të monitorohet në vijimësi dhe në mënyrë sistematike për vlerësimin e nivelit të arritjes së objektivave kundrejt parashikimit. Për të mundur këtë, kjo Strategji do të shoqërohet me dokumentin “*Plan –veprimi për zbatimin e Strategjisë së Zhvillimit 2023-2027*” i cili do të shërbejë për:

- ✓ Të siguroar informacion të përditësuar për progresin e Strategjisë në përgjithësi,
- ✓ Për të identifikuar në kohë vështirësitë apo ndonjë risk të mundshëm që çënon arritjen e objektivave,
- ✓ Vendimmarrje më të mirë dhe përgjigje në kohë ndaj sfidave dhe emergjencave,

Në këtë plan veprimi do të përcaktohen edhe strukturat përgjegjëse për ndjekjen, zbatimin dhe raportimin e aktiviteteve të parashikuara në “Raportin e Monitorimit të Strategjisë së Zhvillimit të KLSH-së”, të çdo viti dhe bëhen të njohura për grupet e interesit, publikun dhe për gjithë stafin e KLSH-së në faqen zyrtare të internetit.